

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 31 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Është kënaqësi e veçantë që një qeverie si kjo juaja t'i drejtohesh me epitetet më karakteristike politike, si e paaftë, si e dalë nga zgjedhje të manipuluar, pa mendim politik, pa mendim ekonomik, që thjesht dhe vetëm improvizon, por edhe për opozitarin më të ashpër, është e rëndë që të akuzosh dikë për mungesë ndjeshmërie sociale dhe humane. Por e meritoni, jo vetëm si qeveri, por në disa raste na detyroni të shkojmë deri në limite dhe t'ju akuzojmë se nuk dispononi as personalisht sensibilitetin e duhur për t'u marrë me çështjet publike në një vend. Nuk mund t'ju akuzoj dhe nuk do ta bëja kurrë, për të qenë realist me vetveten, se ju jeni shkaktarët e pasojave që vijnë nga pandemia, nuk do t'ju akuzoja kurrë as për rastin e pasojave të invazionit rus në Ukrainë.

Të gjithë e dimë, pohohet nga të gjitha anët, në të gjitha drejtimet, se gjendemi përballë një cunami, që do të ndërpresë zinxhirin furnizues, do të rrisë çmimet, do të kufizojë prodhimin në nivel ndërkombëtar dhe nuk jeni ju përgjegjës. Në Gjermani, për shembull, Këshilli i të Urtëve thotë se rritja ekonomike, nga 4,6% që ishte parashikuar, në vitin në vazhdim do të jetë vetëm 1,8 e kështu me radhë. Pse po ju akuzoj? Ju akuzoj se jo vetëm ju mungon aftësia, por edhe vullneti për të lexuar situatën ekonomike dhe shoqërore në vend. Duke mos pasur këtë aftësi dhe këtë vullnet, nuk jeni në gjendje të hartoni politika që mund të përballojnë krizën dhe pasojat e saj të shumanshme, të cilat do të ulen këmbëkryq. Ndërkohë që lexojmë në të gjitha mediet prestigjioze ndërkombëtare, në relacionet e qeverive të vendeve më të fuqishme, se nuk e dimë nëse jemi në fillim apo në mes të këtij cunami, këtu na jepen garanci se kjo nuk do të zgjasë për shumë kohë. Po ju jap një fakt, i cili për mua personalisht është tronditës. Si ka mundësi që ministrat, në një mënyrë që karakterizohet nga cinizmi ekstrem, dalin dhe flasin për shifra që nuk ekzistojnë? Nuk janë konstatime të miat, zotërinj, por po ju lexoj Memorandumin Ekonomik të Bankës Botërore me Shqipërinë, që flet për Shqipërinë që drejtoni ju, zonja Ministre. "Aktualisht trajtohet me ndihmë ekonomike afërsisht 9% e popullsisë në vend, ndërkohë që varfëria është e përhapur në 38%".

Sipas konstatimit të Bankës Botërore, varfëria është e përhapur në 38% të popullsisë, kurse ju trajtoni me ndihmë ekonomike vetëm 9% të popullsisë në Shqipëri. Kjo është shifra më e lartë në Ballkanin Perëndimor. A nuk duhet që dikush, i cili foli këtu më përpara me tone ditirambike për arritjet më të mëdha në Ballkanin Perëndimor, si demonstrim i sensibilitetit elementar, të vendosë mandatin e ministrit, për nderin e të gjithëve ne që merremi me çështjet publike, në dispozicion të Kryeministrit të vet? A mund të ecet me mashtrim? Gënjeni njëherë njerëzit tuaj, të cilëve u keni marrë votën, mashtroni për të mbajtur postet tuaja ata që janë në situatën (nuk dua ta përmend termin, por na detyroni) e kafshatës dhe të gotës së qumështit. Keni një alergji. Më kujtohet që prej vitesh një ish-kolegu juaj i nderuar i maxhorancës, zoti Blushi, fliste për varfërinë, por mënyra se si reagonte i pari juaj

ishte “askush nuk guxon të flasë për varfërinë”. Pse? Sepse jeni shkaktarë të përkeqësimit. Jo se kemi qenë ndonjëherë Luksemburgu për nga niveli i jetesës, por ju e keni thelluar varfërinë.

Për aq vite sa jeni në pushtet, të ardhurat për frymë të qytetarëve shqiptarë mbeten në masën 30% të gjysmës së të ardhurave për frymë të mesatares së Bashkimit European. E ritheksoj për ta kuptuar të gjithë, 30% e gjysmës të mesatares së të ardhurave për frymë të Bashkimit European. Më e keqja, gjatë 9 vjetëve që jeni në pushtet nuk kemi pasur asnjë përafrim, mbetemi te po ky 30%-ësh, kurse ju flisni për harenë e fëmijëve në këndin e lojërave. Me një stoicizëm që dëshmon veç fajësi, fajësia është që nuk doni të hiqni dorë nga vendimet mëkatore të PPP-ve të famshme, na thoni se “po të ulim TVSH-në nuk do të ketë ndikim në çmimin e mallrave”. Si ka mundësi që vende të tjera mendojnë seriozisht zerimin e TVSH-së për bukën? Këto janë vende edhe të Bashkimit European. Pse disa vende do ta aplikojnë këtë politikë duke qenë të sigurta se do të ketë efekte mbi çmimin përfundimtar të pakicës për qytetarin, kurse ju e mendoni ndryshe?

A guxoni t’u thoni qytetarëve se qeveria përfiton nga rritja e çmimeve, sepse rriten të ardhurat? Proporcionalisht me rritjen e çmimeve, rritet TVSH-ja dhe të ardhurat, në një kohë që refuzoni që këto të ardhura t’i vini në dispozicion të politikave për luftimin e varfërisë. Pse? Jini të singertë me veten njëherë, sepse situatat janë të tilla që askush nuk mund t’ju garantojë se do të jeni në pushtet për një, dy apo tre muaj. Mund të jeni edhe më tepër, por do të jeni thjesht dhe vetëm politikisht., sepse asnjëherë nuk keni qenë dhe nuk do të jeni moralisht. Prandaj, zonja dhe zotërinj, edhe në këto momente, kur kudo bëhet një debat thelbësor me përfarim qëndrimesh të maxhorancave dhe opozitave, kjo megalomania juaj është e papërshkrueshme, por ju gjeni dhe bëni.

Të gjithë ata qytetarë që vazhdojnë ende t’ju vijnë pas, që pranojnë akoma të debatojnë me ju dhe ju të jeni përfaqësuesit e tyre, e meritojnë një situatë të tillë, por duhet të reagojnë në mënyrën që secili të ketë mundësi të shprehë pakënaqësinë e vet dhe revoltën ndaj kësaj që po ndodh. Keni arritur shumë gjëra, por për veten tuaj, për një shtet të kapur, keni arritur të neutralizoni edhe vatra të opozitës, ku bëj pjesë edhe unë dhe kjo është pjesa jonë e fajit, por kjo, zotërinj, nuk zgjat shumë. I gëzoheni sa i gëzoheni, por dijeni se pasojat i paguani shumëfish kur vjen momenti i llogaridhënies. Faleminderit!